



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FUSHË-ARRËZ**

Nr. _____ prot

Fushe-Arrez me, ___/___/2024

Procesverbal - Tipi i kontrates - Sherbim

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashk dokumentat e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS - “Plan menaxhimi pyjore”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):
77231400-2 Sherbime te inventarizimit te pyjeve

VLERA E FONDIT LIMIT : 3 083 333 (tre milion e tetedhjet e tre mije e treqind e tridhjet e tre)
leke pa TVSH.

Në bazë të nenit 77, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, në VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 41 , autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Fushë-Arrëz**, ka hartuar procesverbalin për argumenimin dhe miratimin e specifikimeve tenike dhe kriterëve për kualifikimin për procedurën e sipercituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10;*

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2021,2022,2023), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së parashikuar të kontratës. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe nenin 77, pika 3, të LPP, si dhe nenin 43, pika 2/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar..

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: “Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: ”40% të vlerës së parashikuar të kontratës ne procedurat e prokurimit..... dhe ne procedurat e prokurimit “Shërbim Konsulence” si dhe në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet forms elektronike", si dhe në Udhëzimin e Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku përcaktohet se: ”Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare”, si dhe në legjislacionin e fushës ne fuqi, përkatësisht në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike", si dhe në Udhëzimin e Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar.

2.2.2 Kopje të çertifikuara të bilanceve të tre viteve të fundit (2021, 2022, 2023) të paraqitur pranë autoriteteve përkatëse, të konfirmuara nga ky autoritet që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare". Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: "Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme, operatorët ekonomik duhet të paraqesin dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë jo më e madhe se 20% të vlerës së për llogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik per permbushjen me sukses te kontrates, ku shënohen vlerat, afati i perfundimit te kontrates ose fature tatimore te shitjes, ku shenohen data, shumat dhe shërbimet e realizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes ku të shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 55, pika 4 germa b të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" e ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë ne vlerën jo më të madhe se 20% të vlerës së fondit limit,që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

2.3.2 Operatori ekonomik pjesmarres duhet të jetë i pajisur me licencën e nevojshme profesionale per realizimin e shërbimeve objekt kontrate e te cilit duhet te paraqese licensen- të kategorisë III.7.A -Shërbime te ekspertizes dhe/ose profesionale lidhur me pyjet apo kullotat" leshuar nga Qendra Kombetare e Biznesit (QKB).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4 germa a të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” e ndryshuar.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të ketë në përbërje të tij një staf pune të kualifikuar për hartimin e planit të mbarështimit, me eksperiencë në fushat respektive të mbarështimit të pyjeve dhe kullotave, licensuar sipas legjislacionit në fuqi.

Stafi kryesor i kontraktorit do të ketë në përbërje specialistë të profileve si më poshtë:

- **Një Inxhinier Pyjesh** i cili do jete drejtuesi i grupit (staf teknik) i cili do të jete pajisur me "Çertifikatë ekspertit për pyjet dhe kullotat", sipas Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 284, datë 29.04.2022 “Për rregullat, procedurat dhe kriteret për pajisjen me certifikatën e ekspertit në fushën e pyjeve” pika c) hartimin e projekteve të tilla, si projekte komplekse të menaxhimit të pellgjeve ujëmbledhëse, projekte për hartimin e planeve të mbarështimit të pyjeve, kullotave, florës dhe faunës, për pyllëzimet, fidanishtet, trajtimin e pyjeve me prerje kulturore, të sistemimeve malore, përmirësimit të kullotave dhe veprave ujëpirëse në to, të mbritshmërisë, ndërtimin e rrugëve autopsyjore dhe teleferikëve pyjorë; ç) zbatimin e projekteve në fushën e pyjeve, ku përfshihet zbatimi i projekteve të shfrytëzimit, të pyllëzimit dhe projektet që dalin në zbatim të objektivave të planit të mbarështimit të pyjeve.
- **Inxhinier Pyjesh ose Teknik Pyjesh** i cili duhet jetë me pervojë në punimet e terrenit për Hartimin e Planeve të Mbareshtimit dhe që njeh mirë territorin në studim.
- **Inxhinier Topograf ose Gjeodet** (i pajisur me licencë profesionale individuale "**Projektues Gjeodet**", kategoria 8.E sipas lidhjes 2 te VKM nr. 759, datë 12.11.2014 "Për licencimin profesional të individeve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit dhe projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim", i ndryshuar, me pervoje ne punimet e terrenit per Hartimin e Planeve të Mbareshtimit dhe që njeh mirë territorin në studim.

Eksperienca e punës dhe profilet e specialistëve do të duhet të vërtetohen nga ana e kontraktorit me kontratat individuale të punës (e vlefshme gjatë kohës së hartimit të planit), dhe kopje të diplomave.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4, germa b) dhe c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Konkretisht:

Neni 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, pika 4:

[...Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie...] VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Neni 41, pika 4.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatori ekonomik duhet të paraqese dokumentacionin provues si më poshtë vijon:

- Kontratat individuale të punës (te vlefshme gjatë kohës së hartimit të planit), kopje të librezave të punës, kopje të diplomave, jetëshkrimet (CV) si dhe çdo kualifikim tjetër profesional.

Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale etj., reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Kërkesa për staf është e nevojshme për të garantuar Autoritetin Kontraktor se OE disponon kapacitetet me qëllim përmbushjen e objektivave të kontratës, qëllimit dhe rezultateve që pritet të arrihen.

Argumentimi i specifikimeve teknike (termave të referencës):

Termet e referencës/ Specifikimet teknike janë hartuar nga struktura të specializuara/ Grup pune për objektin që prokurohet, i ngritur me Urdhër të Titullarit për hartimin e specifikimeve teknike/ termave të referencave, në përputhje me parashikimet e VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”i ndryshuar Vendim Nr. 498 date 01.08.2024 “Per disa shtesa dhe ndryshime ne vendimin Nr. nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar**, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Objektivi i përgjithshëm i Planit të Mbarështimit duhet të jetë menaxhimi i qëndrueshëm i resurseve pyjore/kullosore në pronësi të Bashkisë Fushë-Arrëz (edhe nga këndvështrimi ekologjik), me strukturë dhe cilësi të mirë në përshtatje me kushtet e zonës dhe në përputhje me objektivat e mbarështimit.

Objektivat specifikë të Planit të Mbarështimit të pyjeve dhe kulotave, do të jenë:

- ◆ Përcaktimi i përdorimit të territorit në përputhje me gjendjen lokale dhe nevojat.
- ◆ Optimizimi i formës së qeverisjes në përputhje me nevojat lokale, mundësitë e grumbullit pyjor dhe mjedisit për të përmirësuar prodhimtarinë.
- ◆ Optimizimi i funksioneve ndërmjet nevojave dhe mundësive ekologjike/silvikulturale në përputhje me rëndësinë multifunktionale, sociale dhe mjedisore të pyjeve.
- ◆ Përmirësimi dhe mirëmbajtja në një gjendje të mirë funksionale të grumbujve pyjor.
- ◆ Rritja e prodhimtarisë së pyjeve me funksion prodhues.
- ◆ Përmirësimi i cilësisë dhe gjendjes së grumbujve të trungishteve me funksion prodhues.
- ◆ Nxitja dhe përdorimi i ripërtëritjes natyrore sa më shumë që të jetë e mundur me qëllim që të krijohen ekosisteme pyjore që i përshtaten mjedisit.

- ◆ Pakësimi i impakteve negative në gjendjen fitosanitare të pyjeve dhe prerjeve të paligjshme.
- ◆ Rehabilitimi dhe garantimi i rritjes së qëndrueshme të prodhimtarisë në sipërfaqet pyjore/kullosore.
- ◆ Sigurimi i pjesëmarrjes së gjërë të popullsisë lokale në marrjen e vendimit për menaxhimin e pyjeve/kullotave.
- ◆ Përmirësimi i menaxhimit të pyjeve duke lidhur resurset pyjore/kullosore me interesat e përdoruesve.
- ◆ Menaxhimi i punës për hartimin e planit dhe futjen e tij në Sistemin e Informacionit Shqiptar në Pyje (SISP).

Hartimi i PMPK duhet të bëhet bazuar në parimin e mbarështimit të qëndrueshëm që nënkupton "të ruajë dhe të forcojë gjendjen shëndetsore të ekosistemeve pyjore për një afat kohe të gjatë dhe në të njëjtën kohë për të siguruar mundësi ekologjike, sociale, ekonomike dhe kulturore për mirëqenien e brezave aktuale dhe atyre të ardhshëm". Ky plan hartohet për ekonominë pyjore që është pjesë e Bashkisë Tiranë dhe natyrisht në kordinim edhe me njësitë e tjera ekonomike fqinje apo zonat e mbrojtura nëse është e nevojshme.

Hartimi i Planit të Mbarështimit është një mjet për të njohur gjendjen aktuale të territorit, siguron një ndërveprim me aktoret dhe Bashkinë si dhe kordinim me institucionet qendrore nëpërmjet përdorimit të Sistemit të Informacionit Shqiptar në Pyje (SISP) dhe kjo duhet të ndodhë gjatë hartimit të PMPK dhe gjatë drejtimit të ndërhyrjeve dhe ngjarjeve në periudhën e vlefshmërisë së planit.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhena të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.